



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Doretuzat Primišteno / Prodato Received / Delivered	07-04-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojç Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SP/MSHUK	3461/2023		113



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr. 400/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 400/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi rruga „Ëilam Ëalker“, nga Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “vlerësim i punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A .nr. 400/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankues.
- II. MBETET në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 31.01.2023 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin për vitin 2022.
- III. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, me datë 22.02.2023 me numër protokollit 1992/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin vjetor për vitin 2022 të vlerësuar nga Kryesuesi i Zyrës Rajonale të AKKVP, me pretendimet se nota e përgjithshme vlerësimit prej 3.80 në është në

harmoni me rezultatet e punës së tij si dhe tek pjesa e vlerësimit që ka të bëj me disiplinë, respektimit të orarit të punës., është vlerësuar me notën 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.02.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Ndërsa me datë 09.03.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.02.2023, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 1992/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formuari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesin Elvir Murati; e - maili i datës 31.01.2023; e- mali i datës 01.12.2022; e- mali i datës 06.12.2022; e- mali i datës 22.12.2022; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 28.12.2020; e- mali i datës 23.01.2023; e- mali i datës 16.02.2023; Përshkrimi i detyrave të punës; Objektivat/ detyrat e punës për vitin 2022; Përgjigje në Ankesë e datës 09.03.2023, me numër protokollit 2521/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit Elvir Murati, është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi mban pozitën Zyrtar Rajonal në Zyrën Regjionale në Prizren në Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronave, ndërsa udhëheqësi i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 31.01.2023 ankuesin ka vlerësuar me notë të përgjithshme 3.80, ku ankuesi ka paraqitë kundërshtimin e tij duke mos e nënshkruar Formularin e Vlerësimit.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sa i përket notës së përgjithshme të vlerësimit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nën 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: *“Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.4. nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “shumë mirë”; dhe”* ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: *“Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: “shumë mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”,* prandaj marrë për bazë Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për ankuesin i datës 31.01.2023 përmes të cilat ankuesi ishte rivlerësuar me notë të përgjithshme mesatare 3.80, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ankuesi është vlerësuar *“shumë mirë”* në kuptim të dispozitave të lartcekura të rregullores, nga rrjedh si i njëjti jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave

dhe performancën e përgjithshme të institucionit, andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit i paraqitur në ankesën e datës 22.02.2023 të parashtruar në Këshill është i pabazuar, ngase udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë nuk ia ka mohuar përkushtimin në punë sikurse as realizmin e të gjitha objektivave, gjegjësisht të njëjtin e ka vlerësuar përtej pritjeve.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt nuk ka bërë përcaktimin e objektivave të punës si dhe rifreskimin e tyre, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se pretendimi i ankuesit nuk qëndron, sepse Menagjerja e Personelit i ka udhëzuar të gjithë të punësuarit për regjistrimin e objektivave në sistem përmes e-maillit të datë 06.12.2022, ndërsa sa i përket objektivave të punës ato kanë qenë të përcaktuara përmes Formularit për "Objektivat/Detyrat e Punës për Vitin 2022 i cili formular është nënshkruar nga ankuesi me datë 26.01.2022 dhe mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt.

Prandaj, nga analizimi i shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit sikurse edhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme mesatare "3.80" e që në kuptim të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik vlerësohet se i njëjti jo vetëm që i ka arritur të gjitha objektivat e punës, por ka ndikuar edhe performancën e përgjithshme të institucionit, prandaj mbi këtë bazë udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 7 të së njëjtës rregullore.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 400/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Esmer SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit i;
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës;
- Arkivit të KPMSHCK-së